

Evropa Qendrore

përpiluar nga redaktorët

Përmendje e hershme | Sllovakia, Bohemia dhe Moravia | Hungaria Qendrore dhe Transilvania | Profesionet | Të paligjshmit dhe taksapaguesit

➤ *Fati i romëve në Evropën qendrore në mes të arritjes së tyre dhe shekullit të 18-të fuqimisht përcaktohet nga shumë luftëra dhe ndryshime politike që patën ndikim në rajon, në veçanti konflikti konstant në mes të Perandorisë Otomane dhe Perandorisë të Shenjtë Romake. Deri në fund të shekullit të 17-të, kur një tërheqje rapide e turqve ndodhi me betejën e Vjenës në vitin 1683, romët në tokat hungareze përballëshin me dy politika të ndryshme. Nën sundimin otoman, zejtaria dhe muzika rome vlerësohej në masë të madhe. Në zonat e kontrolluara nga Habsburgu, ato vështirë se toleroheshin. Sidoqoftë, në disa regjione, posaçërisht në regjionet e Hungarisë perëndimore që kufizoheshin me tokat e mbretërisë Habsburge, këto dy qasje ekzistonin paralelisht, duke i ekspozuar “Ciganët” ndaj kushteve vazhdimisht të ndryshuara.*

PARATHËNIE

Më parë se një entitet fizik “Evropa qendrore” është një koncept i historisë së përbashkët. Ajo përbëhet nga Austria e sotshme, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Sllovakia, Sllovenia dhe ish regjionet Austro-Hungareze të Bukovinas, Galicias, Transilvanisë dhe Vojvodinës qendrore, si dhe Gjermania, Polonia, dhe Zvicra në periferi. Në këtë artikull “Evropa qendrore” i referohet vetëm regjioneve qendrore. (Ill. 1)


PËRMENDJE E HERSHME

Për tokat çeke, është sugjeruar se romët kishin ardhur në gjysmën e shekullit të 13-të. Shumica e autorëve ndajnë mendimin se romët filluan të paraqiteshin në këto toka gjatë pjesës së dytë të shekullit të 14-të, për shkak të rritjes së referencave për “Ciganët” në regjistrat lokal të regjioneve sllovaqe të Hungarisë. Një

fshat “Ciganvaja” ekzistonte që nga viti 1388, dhe një numër i familjeve që jetonin aty filluan të përdornin mblëmërinë “Cigany” ose “Cigan”. Në vitin 1399 në Librat e Ekzekutimeve të Lordëve të Rozhemberk në Boheminë jugore, përmendet se përveç disa gjermanëve në bandën e hajdutëve, ishte “një Cigan, shërbëtori i Andrew”. Gjithashtu ekzistojnë dëshmi nga 1370-at për praninë e romëve në Zagreb (Zágráb), kryeqytet-

in e Kroacisë që atëherë ishte afërsisht e lidhur me Hungarinë.

Dëshmia e parë e padiskutueshme e romëve në Hungari daton me 1416, kur të dhënat tregojnë se në qytetën e Brasov në Transilvani njerëzit i kishin dhënë ushqim dhe para “Lordit Emaus të Egjiptit dhe 120 shoqëruesve të tij”. Mbreti Sigismund I (1387-1437), që edhe de facto ishte Perandori i Shenjtë Romak, iu kishte dhuruar grupeve



Slllovakia, Bohemia dhe Moravia

Hungaria qendrore dhe Transilvania

Profesionet

Të paligjshmit dhe taksapaguesit

Nga dekreti i Mbretit Matthias Corvinus, i vitit 1476. .:

“Kemi arsye t’i shprehim vetvetiu ankesat shqetësuese që na kanë arritur nga qytetarët e qytetit të Cibines. Ju, populli juaj, dhe ndjekësit tuaj janë duke i quajtur njerëzit, të cilët janë vendosur nën kështjellën e kësaj komune dhe të cilët punojnë si punëtorë ditor; ‘Czigány’ ose Egjiptas, sikurse mund të konstatohet nga disa prej dekretëve tona. Ne kemi urdhëruar prefektin e kësaj komune mos t’i prek ata në aspektin personal dhe pronësor dhe mos t’i ri-pyes [por ndonjë detyrë ose punë]. [...] Prandaj, ne po i marrim ata nga pushteti dhe juridiksioni juaj dhe i shërbyesve tuaj. Kështu që shprehimisht urdhërojmë Besnikërinë Tuaj, që në të ardhmen të zbatoni dhe urdhëroni që subjektet tuaja mos të shqetësojnë, lëndojnë apo pyesin ‘Czigány’ e lartpërmendur, dhe ju urdhëroheni ta ndaloni këtë. [...]”

III. 2

(nga Tcherenkov / Laederich 2004, f. 97)

të “Ciganëve” leje udhëtimi në vitet 1417 dhe 1423. Grupit të parë si duket iu ishte mundësuar udhëtimi falas, sepse romët, të cilët kishin kaluar një kohë në Perandorinë Otomane, posedonin informata të rëndësishme ushtarake për turqit. Grupi pastaj kaloi përmes Bohemisë në rrugën e tyre për Evropën perëndimore. Leja e dytë e vitit 1423 nga Sigismund iu ishte dhënë udhëheqësit Ladislaus dhe përcjellësve të tij.

SLLOVAKIA, BOHEMIA DHE MORAVIA

Romët e vendosur në Slllovakë punonin si muzikantë dhe punues të metalit, dhe shumë nga ta shërbenin në ushtritë e monarkëve të Hungarisë. Në pjesën e fundit të shekullit të 15-të ekziston një numër i komenteve për trupat e “Ciganëve” në të dhënat hungareze, dhe trupat romë ishin përdorur në konfliktet që përfshiu Slllovakinë gjatë tërë shekullit pasues.

Politika anti-“Cigane” në Slllovakë u shfaq pas fitores së turqve ndaj hungarezëve afër Mohács në vitin 1526. Disa gjurmë të këtij qëndrimi veçse ki-

“ATA JETOJNË NJË JETË SHUMË TË VËSHIRË”

Zyrtari i Qarkut (guvernatori perandorak) i Hungarisë Mbretërore, György Thurzo, lëshoi një letër të mrekullueshme të sjelljes së sigurt në vitin 1616. Ky dokument i referohet posaçërisht Vojvodës Franciscus dhe shoqërisë së tij, që thuhet se kanë “bërë shërbime ushtarake” (kështu që autoritetet kishin një interes të veçantë t’i kenë në dispozicion), por përmbante një lutje të përgjithshme për mirëkuptim ndaj gjendjes së vështirë të Ciganëve:

“Derisa zogjtë në qiell kanë foletë e tyre, dhelprat tokën e tyre, ujqit shtrofullat e tyre, dhe luanët dhe arinjtë strofkat e tyre, dhe të gjitha shtazët kanë vendin e tyre të banimit, raca me të vërtetë e mjeruar e Egjiptasve, të cilët ne i quajmë Cingaros, me siguri se është për të ardhur keq, edhe

pse nuk dihet nëse kjo është shkaktuar nga tirania e Faraonit mizor apo diktatit të fatit. Në pajtim me zakonet e tyre antik ata janë mësuar të jetojnë një jetë shumë të vështirë, në fusha dhe livadhe jashtë qyteteve, nën tenda të vjetra. Kështu të vjetrit dhe të rinjtë, djemtë dhe fëmijët e kësaj race mësuan, të pambrojtur nga muret, ta përballojnë shiun, të ftohtit dhe nxehtësinë e fortë; ata nuk kanë të mira të trashëguara në këtë tokë, ata nuk i kërkojnë qytetet, fortesat, qytezat ose vendbanime princërore, por bredhin vazhdimisht pa ndonjë vend të sigurt pushimi, pa njohur pasuri ose ambicie, por, ditë për ditë dhe orë për orë, duke kërkuar në qiell të hapur për ushqim dhe veshmbathje përmes punës me duart e tyre, duke përdorur kudhurat, shakull, çekan dhe mashë.”

III. 3 (nga Fraser 1992, f. 155; e cituar si “nga latinishtja në H. M. G. Grellmann, ‘Historischer Versuch über die Zigeuner’”, e vitit 1787)


shin qenë të dukshme në shekullin e kaluar, kur slllovakët filluan t’i shikojnë “Ciganët” si spiunë të tartarëve. Frika nga turqit, që pas pushtimit të Budas në vitin 1541, pushtuan Hungarinë qendrore, krijoj një bazë të re për ndjenjën anti-“Cigane” në territoret veriore dhe perëndimore hungareze që ishin të kontrolluara nga Habsburgu. Romët në Slllovakë, si të vendosurit ashtu edhe nomadët, në masë të madhe tani ishin të ndarë nga fshatarët slllovak dhe hungarez, dhe banorët e rinj “Cigan” ishin të kufizuar në periferitë e qytezave dhe fshatrave. Përveç kësaj, ndikimi i ngritur i gidave i pamundësoi farkëtarët romë të merrnin pjesë në sektorët më fitimprurës të punimit të metalit.

Pas pushtimit turk të Hungarisë qendrore u themeluan tri mbretëri të ndara në vitet 1541-42. Slllovakia dhe Hungaria perëndimore, e quajtur Hungaria Mbretërore, ishin nën sundimin Habsburg, ndërsa Hungaria qendrore-“Magyar” – ishte nën kontrollin direkt të otomanëve. Turqit gjithashtu krijuan një shtet marionetë, Transilvaninë. Për romët, kjo nënkuptonte zbatimin e politikave të pabarabarta. Në veçanti, romët në Hungarinë Mbretërore vuanin nga

politikave të përjashtimit. Në anën tjetër këta ishin të varur nga lordët regional, pasi që disa vlerësonin dhe ruanin aftësitë e romëve, ndërsa tjerët jo.

Në Moravi dhe Bohemi legjislacioni anti-“Cigan” ishte nxjerr nga viti 1538 e më tej. Me sa duket, në vitin 1556, zemërimi ndaj romëve doli jashtë kontrollit, dhe qeveria u desh të ndërhyj për të ndaluar “mbytjen e grave dhe fëmijëve romë”. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, të dhënat lokale tregojnë se lëmosha dhe letrat e rekomandimit iu kishin dhuruar “Ciganëve” nga këshillat e qytetit, dhe romët tjerë vazhduan të udhëtojnë në tokat Çeke.

Lufta tridhjetë vjeçare (1618-1648) solli një zemërim çdo herë e më të rritur ndaj romëve. Uria, epidemitë, dhe ikjet patën ndikim në regjionet e Bohemisë dhe Moravisë. Kjo shkaktoi që shumë romë edhe nga pjesët tjera të Evropës të iknin në Slllovakë, ndërsa në anën tjetër masat të synuara posaçërisht ndaj ardhësve të rinj u forcuan. Sipas ligjit, “Ciganët” slllovak ndaloheshin të jetonin një jetë nomade; por për shkaqe ekonomike, ata ishin të detyruar të bënin një gjë të tillë. Nga viti 1697 e më tej, perandorët urdhëruan dekrete gjith-



KUSHTET NDRYSHUESE

Pozita e “Ciganëve” në Hungarinë përëndimore ndryshonte sipas qarkut të cilit i takonin. Për shembull, Kontët e Batthyány, me lokacion në Nemet-ujvár (Güssing i sotshëm në Burgenland, Austria), ku pa paragjykimë ndaj romëve, në vitet 1664 dhe 1674 një numër i vendbanimeve të “Ciganëve” u ndërtuan në regjion. Përveç Batthyány, të cilët mbështetnin turqit, Eszterházy i lidhur me Habsburgun tentuan të largojnë “Ciganët” nga territoret e tyre. Prandaj romët shkuan në jug të qarkut Batthyány.

Qasjet e ndryshme në regjione të ndryshme shpesh nuk reflektonin politikat e përgjithshme të pushtetit më të lartë, perandorit apo mbretit. Një sundimtar i caktuar shpesh nxirrte dekrete thjesht për të zbutur ndjenjat anti-“Cigane” të popullsisë vendase, duke shpërfillur – apo duke mos ditur për – faktin se shumë romë ushtronin zeje të rëndësishme konsiderueshme për regjionet.

III. 5 (shiko Mayerhofer 1988, f. 18)

III. 4 Letra e György Thurzo e vitit 1612

(nga Mayerhofer 1988, f. 16)

një e më të ashpra, duke deklaruar se “Ciganët” do të jenë “vogelfrei” (të paligjshëm), do të trajtohen “me tërë ashpërsinë e mundshme si ndaj trupit ashtu edhe pronës”, do të varen pa gjykim, do të fshikullohen ose dëbohen përgjithmonë, do të damkosen në shpinë, etj.

HUNGARIA QENDRORE DHE TRANSILVANIA

Romët në Hungari trajtoheshin me më shumë tolerancë se që ishte e zakonshme në Evropën përëndimore në shekullin e 15-të deri në shekullin e 17-të. Kjo ishte pjesërisht për shkak të reputacionit që fituan për aftësitë e tyre për zejen e metalit, për muzikën e tyre, dhe si ushtarë. Sidoqoftë, mbi të gjitha, Hungaria qendrore dhe lindore nga fillimi i shekullit të 16-të e tutje, ishte pjesë e Perandorisë Otomane, e cila, krahasuar me shtetet përëndimore, ndiqte një politikë të tolerancës ndaj shumë grupeve etnike nën sundimin e saj.

Në një dekret të vitit 1476, Mbreti Matthias Corvinus i bëri Romët subjekte direkt të mbretit në bashkësinë e Cibines (Hermannstadt, tani Sibiu),

në Transilvani. Mbreti është dashur t’i përsëris urdhrat e tij pas njëmbëdhjetë viteve; në këtë dekret ai përmendi de tytrat që “Ciganët” duhej t’i kryenin në mbrojtje të Cibines (Sibiu) dhe privilegjet speciale që i gëzonin që nga “kohërat e stërlashta”. Ai pastaj iu referua “lirisë së vjetër dhe privilegjeve” të “Romëve”, prandaj edhe caktimi i tyre direkt në mbretëri. [III. 2]

Ulászló (Ladislaus) II nxori një dekret me përmbajtje të ngjashme me Tamás Polgár, “vayvodam Pharaonum” (Vojvoda i popullit të Pharaoh), në vitin 1492. Kjo leje udhëtimi i mundësonte Polgárit “të lëvizte dhe vendosej kudo që ai dëshironte në vend me 25 tendat e tij të farkëtarëve cigan”. Farkëtarët e Polgárit e furnizuan peshkopin Sigismund i Pécs, në mes të tjerave, me mushqetë dhe gjyle topi si dhe me pajisje të rënda ushtarake.

Letrat e sjelljes së sigurt të lëshuara në një numër të madh që nga fillimi i shekullit të 15-të e më tej, ishin të vlefshme vetëm për udhëheqësin e caktuar dhe grupin e tij të emëruar në dokument. Grupet e ndryshme të romëve trajtoheshin ndryshe, varësisht nga dobishmëria e shërbimeve të tyre

apo shkallës së trazirës përmes së cilës popullata vendase shprehte ndjenjat e saj kundër “Ciganëve”. Kjo ilustron mirë përmes dy dokumenteve të lëshuara nga György Thurzo, ushtar i Hungarisë Mbretërore. Një letër nga Thurzo e vitit 1612 urdhëronte që të gjitha grupet e romëve, të cilët, duke ardhur nga Stiria, bridhnin përmes tokave të Hungarisë përëndimore, të dëboheshin nga atje. Dokumenti citon ankesat e popullatës vendase, që akuzonte “Ciganët” për plaçkitje dhe vjedhje. Sidoqoftë, në vitin 1616, Thurzo lëshoi një letër të sjelljes së sigurt të adresuar një grupit të posaçëm të “Czingaros”, shërbimet ushtarake të të cilëve konsideroheshin të dobishme. Ky dokument i fundit përmban, sikurse thuhej, “një lutje të prerë për mirëkuptimin e gjendjes së vështirë të Ciganëve”; si duket ishte e domosdoshme për ushtarin t’i paraqiste arsyet e mira për mbrojtjen speciale të një grupi të “Czingaros”. [Illa. 3, 4]

Në shekullin e 16-të zakoni ishte vendosur në Hungari që shefi i “Ciganëve” të caktohej nga autoritetet e që do ishte nga mesi i tyre; atij i jepej titulli i “egregius”. Në secilin “komitat” (qark) hungarez emërohej një “egregius”; ai

kishte të drejtë të martohej jashtë klanit të tij dhe ishte përgjegjës për të gjitha çështjet ligjore lidhur me 200 ose 300 njerëzit e tij. Nën të, në secilin qark me popullatë rome, kishte shefa më të ultë të cilët vepronin si gjyqtarë në çështjet e “Ciganëve”. Sidoqoftë, mbledhja e taksave nga “Ciganët”, bëhej nga disa vojvodë të cilët ishin zgjedhur nga rangjet e fisnikërisë së Hungarisë dhe Transilvanisë.

PROFESIONET

Disa dokumente nga viti 1503 e më tej tregojnë se shumë romë në Evropën qendrore ishin krijues të armëve. Veçanërisht, krijimi i topit dhe gjyleve të topit përfshinte njohuri shumë të specializuara të teknologjive më të përparuara luftarake të asaj kohe. Një numër i madh i romëve gjithashtu shërbenin në ushtrinë hungareze. Kur Janos Zápolyai mori frontin hungarez përmes përkrahjes otomane në vitin 1528, ai i shpërbleu besnikët romë me përtëritjen e “lirive antike rome” (antiquis libertatibus) të dhuruara nga paraardhësit e tyre.

Muzikantët romë ishin shumë të lavdëruar nga fisnikëria dhe anëtarët e oborrit. Në një letër të vitit 1543 nga oborri transilvanian i Mbretëreshës Isabella, gruas së Janos Zápolyai, shkrimtari thotë se “muzikantët më të shkëlqyer egjiptas lozin, paraardhësit e Pharaohs”. Ai vazhdonte të vërente se instrumentistët “Ciganë” të okarinës “nuk iu bien telave me gishtërin-

jtë e tyre por me një shkop druri dhe këndojnë në përcjellje të saj me tërë fuqinë e tyre”.

Shumë romë në Hungarinë qendrore u bënë farkëtarë për ushtrinë turke. Të tjerët ishin muzikantë, berberë, bërës tendash, lajmëtarë apo xhelatë. Të dhënat nga regjistrimi otoman i taksave nga kryeqyteti i Hungarisë qendrore, Buda, tregojnë se 56 meshkuj romë kanë jetuar aty deri në vitin 1564. Numri i “Ciganëve” u ngrit në 90 gjatë 30 vjetëve të ardhshëm. Veçanërisht në Hungarinë Mbretërore, disa fisnikë tentuan t’i shfrytëzonin aftësitë e romëve. Sidoqoftë, banorët e rinj romë u shtynë në periferitë e fshatrave dhe qytezave.

TË PALIGJSHMIT DHE TAKSAPAGUESIT

Për pjesën më të madhe të shekullit të 17-të, situata në tokat hungareze mbeti e paqëndrueshme. Në Hungarinë Mbretërore kufizimet e reja hynë në fuqi, e që ishin të drejtuara kundër “Ciganëve” të huaj, nomadë, por që kishte ndikim në të gjithë romët në këto territore. Kur hungarezët që lidheshin me Habsburgun ripushtuan pjesët e mëdha të Hungarisë perëndimore në vitin 1688, romët në masë të madhe prapë ishin pa të drejta. Përveç kësaj, ata humbën profesionet e tyre, pasi që më nuk kishte ushtarë armët e të cilëve ata do t’i ripararin, dhe të cilët do t’i shoqëronin me muzikë. Atyre u mungonin aftësitë bujqësore,

dhe në territoret që ishin gjerësisht të braktisura nuk kishte kërkesë për tregti. Prandaj, shumë nga ta shkuan drejt perëndimit, për të plaçkitur. Kjo ishte historia e dekretëve dhe patenteve të atëhershme që ishin gjithnjë e më të shumta kundër romëve, të cilat, përveç zhvillimeve tjera, në shekujt e ardhshëm shpëton në ndjekjen e haptë të „Ciganëve“ në pyjet e Hungarisë perëndimore.

Në vitin 1706, duke konfirmuar dekretet e “Reichstag” të viteve 1497-98, Perandori Austriak Leopold I, i deklaroi romët si kriminel dhe ua ndaloi hyrjen e tyre në territoret e Habsburgut. Ai kishte ngritur “taffeln” (pankarta paralajmëruese) për të informuar romët që dëshironin të hynin në këto territore për këto rregullore. “Taffeln” i shkruar shpejt u desh të zëvendësohet me fotografitë e gjalla të “Romëve“ të gjymtuar për romët, të cilët nuk dinin të lexonin.

Ashpërsia e këtyre politikave filloi të ndryshojë pas vitit 1710. Fisnikëria lokale hungareze i kishte duart e lira për të udhëhequr çështjet e tyre të brendshme në shkëmbim me besnikërinë e tyre ndaj mbretërisë. Përveç kësaj, Hungaria qendrore e brakisur ishte ri-populluar me rreth 400,000 njerëz nga regionet sllovaqe të Hungarisë veriore. Oborri hungarez reformoi sistemin e taksave; kjo vuri ngarkesa të reja edhe ndaj “Ciganëve”, të cilët tani duhej të paguanin taksa vjetore në tërë vendin, dhe kështu në fund të fundit pranoheshin si qytetarë.

BIBLIOGRAFIA

Crowe, David (1995) *A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia*. London / New York: I. B. Tauris Publishers | **Fraser, Angus (1992)** *The Gypsies*. Oxford / Cambridge: Blackwell | **Mayerhofer, Claudia (1988)** *Dorfzigeuner. Kultur und Geschichte der Burgenland-Roma von der Ersten Republik bis zur Gegenwart*. Wien: Picus | **Tcherenkov, Lev / Laederich, Stéphane (2004)** *The Roma. Volume 1: History, Language and Groups*. Basel: Schwabe



© Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjete, elektronike (CD-Rom, Internet, etj.) ose mekanike, përfshirë fotokopjimi, incizimi apo sistemi i ruajtjes ose mbajtjes së informatave, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i Botimit, Drejtoria e Komunikimit (F-67075, Strasbourg cedex ose publishing@coe.int)



PROJEKT PËR EDUKIMIN E
FËMIJËVE ROMË NË EVROPË
<http://www.coe.int/education/roms>

[romani] PROJECT <http://romani.uni-graz.at/romani>